

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2026.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR , PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT

Data 06.07.2026

Drejtuar

Operatorit Ekonomik (OE) : Blerina Sadiku P.Fizik NUIS K97730102T dhe me Adresë:
Tirane Njesi Administrative Bathore Rr uga at Zef Pllumbi ,pallati nr 16 Deivi 2001,Kati0
,Pasuri nr 39/118 -n9 zona kadastrale 2679 vol 31.Mezez ,Tirane

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: E hapur e thjeshtuar, Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) muaj..

Numri i referencës së procedurës: REF-85937-05-18-2026

Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “ Blerje Uniforma dhe veshje të tjera speciale”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Veshje, këpucë, artikuj valixhe dhe aksesorë 18000000-9

Veshje profesionale, rroba pune të veçanta dhe aksesorë 18100000-0

Veshje profesionale 18110000-3

Fondi limit: 9,932,756.67 (nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind pesëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: me afat 24 (njëzet e katër) muaj nga lidhja e draft-marrëveshjes

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **19.05.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike **Nr.33 datë 25 Maj 2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike me e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike me e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori Ekonomike ATLANTIK 3 me NUIS K22218003V

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 0 (ZERO)

Çmimi total i Ofertës me TVSH është: 0 (ZERO)

2. Operatori Ekonomike Blerina Sadiku P.Fizik me NUIS K97730102T

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,567.50 (Shtate milion e katerqind e dyzet e nente mije e pesëqind e gjashtedhjetë e shtate pike pesë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481.00 (Tete milion e nentëqind e tridhjetë e nente mije e katerqind e tetëdhjetë e një) leke

3.Operatori Ekonomike Desa & Co shpk me NUIS L81807027M

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,225,550 (shtate milion e dyqind e njetzet e pese mije e pesëqind e pesëdhjetë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,670,660 (tete milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mije e gjashtëqind e gjashtedhjetë) leke

4.Operatori Ekonomike EXTRABIS Shpk me NUIS L22218008Q

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,568 (Shtate milion e katerqind e dyzete nente mije e pesëqind e gjashtedhjetë e tete) Leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481.60 (Tete milion e nentëqind e tridhjetë e nente mije e katerqind e tete dhjetë e një pike gjashtëdhjetë) leke

5.Operatori Ekonomike Grelek shpk me NUIS M12410008F

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,567.50 (shtate milion e katerqind e dyzet e nente mije e pesëqind e gjashtedhjetë e shtate pike pesëdhjetë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481 (tete milion e nentëqind e tridhjetë e nente mije e katerqind e tetëdhjetë e një) leke.

6.Operatori Ekonomike MALBERTEX shpk me NUIS K 71821009 N

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,874,040 (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 9,448,848 (nëntë milion e katërqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e dyzetë e tetë) leke

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori Ekonomike ATLANTIK 3 me NUIS K22218003V

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 0 (ZERO)

Çmimi total i Ofertës me TVSH është: 0 (ZERO)

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të Kreut X, Nenit 82, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Pas hapjes së ofertave, u konstatua se Operatori Ekonomik **ATLANTIK 3 NUIS K22218003V**, nuk ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik asnjë dokumentacion ligjor dhe teknik. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave. Mungesa e dokumentacion ligjor dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomike **ATLANTIK 3 NUIS K22218003V**, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur ofertë te pavlefshme.

2.Operatori Ekonomike Desa & Co shpk me NUIS L81807027M

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,225,550 leke(shtatë milion e dyqind e njezet e pese mije e pesqind e pesedhjetë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,670,660 leke(tete milion e gjashtëqind e shtatedhjetë mije e gjashtëqind e gjashtedhjetë)leke

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) , nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekonomik dhe teknik të paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se Operatori ekonomik **Desa & Co shpk me NUIS L81807027M** nuk permbush kriteret per kualifikim te përcaktuar ne dokumentat standarte të tenderit si me poshte:

- OE nuk ploteson shtojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE per disa zera si me poshte :

Per Zerin 13 nuk ka standartin EN/ISO 342:2003 i cili eshte per Veshjet mbrojtëse - Tërësitë e veshjeve dhe artikujt e veshmbathjeve për mbrojtjen kundra të ftohtit sipas kërkeses ne DST.

Per Zeri 2 DST ka kërkuar 100% jo metalike, ndërsa produkti i ofruar ka mbrojtëse gishtash prej çeliku; shtresë anti-shpim prej çeliku. DST kërkon mbrojtëse kompozite për gishtat, ndërsa është ofruar çelik. DST kërkon shollë të mesme anti-shpim kompozite, ndërsa është ofruar çelik. Nuk janë provuar ose deklaruar specifikimet: membranë 100% ujëdaluese; anti-rëshqitje SRC; rezistencë ndaj nxehtësisë; rezistencë ndaj vajrave; absorbim energjie.

Per Zerin 9 OE ka deklaruar AUTORIZIM PRODHUESI Sacobel B.V per zerat 9. Doreza pune nitrile 12. Pelerinë por referuar katalogeve per zerin 9 Skede Teknike Art.5071NB nuk perputhet me specifikimet teknike te kerkuara ne DST nderkohe per zerin 9 perputhet Skede Teknike Art. BTW012 e prodhuesit JINHUA HENGFA INDUSTRY CO., LTD ku nuk perfshihet ZERI 9. Doreza pune nitrile (Për elektrikist).

Per zerin 12 pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për pelerinën e shiut, konstatohet se produkti i ofertuar nuk përputhet plotësisht me specifikimet e kërkuara. Konkretisht, kërkohet pelerinë ngjyrë portokalli, pa jakë, pa astar të brendshëm, me stampim logosh përpara dhe prapa, si dhe me dy shirita fosforeshentë në krahë dhe në trup. Ndërsa në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet një pelerinë me veshje të brendshme prej poliesteri, me jakë ku paloset kapuçi, me dy shirita reflektues vetëm rreth gjoksit dhe pa informacion mbi stampimin e logove. Gjithashtu, nuk paraqiten të dhëna për gramaturën e materialit 320–350 gr/m² të kërkuar në specifikimet teknike. Për rrjedhojë, artikulli nuk provon përputhshmëri të plotë me kërkesat teknike të përcaktuara. Si dhe ngjyra është jeshile.

Per Zerin 21 Nuk provohet përputhshmëria me standardin SSH EN 166:2001 ose ekuivalentin e tij, si dhe nuk dokumentohen të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara."

Sa me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit Ekonomik **Desa & Co shpk me NUIS L81807027M** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, **duke e skualifikuar kete operator ekonomik.**

3. Operatori Ekonomike EXTRABIS Shpk me NUIS L22218008Q

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,568 (Shtate milion e katerqind e dyzete nente mije e peseqind e gjashtedhjetë e tete) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481.60 (Tete milion e nenteqind e tridhjetë e nente mije e katerqind e tete dhjetë e nje pike gjashtedhjetë) leke

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) , nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekonomik dhe teknik të paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se Operatori ekonomik **EXTRABIS Shpk NUIS L22218008Q** **nuk** përmbush kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit si me poshte:

- OE nuk ploteson shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE për disa zera si me poshte :

Per zerin 2 pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për këpucët antistatike, konstatohet se produkti i ofertuar nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara. Në specifikimet teknike është kërkuar që këpucët të jenë 100% jo metalike, të pajisura me mbrojtëse gishtash kompozite dhe me shollë të mesme anti-shpim kompozite. Ndërsa produkti i ofertuar është i pajisur me mbrojtëse gishtash prej çeliku dhe shollë të mesme anti-shpim prej çeliku, çka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara. Gjithashtu, nga dokumentacioni i

paraqitur nuk provohet prania e membranës 100% ujëdaluese dhe as karakteristika e rezistencës ndaj nxehtësisë. Për rrjedhojë, artikulli nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

Per zerin 3 Çizme pune llastiku nuk ka ngarkuar asnje dokument provues

Per zerin 6.Bluze T-shirt me mende te shkurtra nuk ka ngarkuar asnje dokument provues

Per zerin 9.Doreza pune nitrile (Për elektriciist) pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për dorezat e punës nitrile për elektriciistë, konstatohet se produkti i ofertuar nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara. Në dokumentet e tenderit janë kërkuar doreza izoluese për punime nën tension, me voltazh operativ 7500 Volt, Klasi 1 dhe në përputhje me standardin EN 60903:2003/IEC 60903 ose ekuivalentin SSH EN 60903:2003. Ndërsa produkti i ofertuar është një dorezë pune e përgjithshme me veshje nitrili, e certifikuar sipas standardeve EN ISO 21420 dhe EN 388 për mbrojtje mekanike. Nga dokumentacioni i paraqitur nuk evidentohet certifikimi sipas EN 60903, klasa e izolimit elektrik dhe as voltazhi operativ i kërkuar. Për rrjedhojë, artikulli nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

Per zerin 12 Pelerina pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për pelerinën e shiut, konstatohet se produkti i ofertuar nuk provon përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara. Në veçanti, nuk përputhet gramatura e materialit, pasi është kërkuar masë 320–350 gr/m², ndërsa produkti i ofertuar deklarohet me peshë 200 g. Gjithashtu, nuk evidentohet përputhshmëria me kërkesat për modelin monopet, mbylljen me zinxhir plastik deri në mes, si dhe praninë e dy shiritave fosforeshentë në të dy krahët dhe në trup. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk provon plotësisht përmbushjen e specifikimeve teknike të artikullit.

Per zerin 14. Pantallona pune nuk ka ngarkuar asnje dokument provues

Per zërin 17. Kominoshe fosforeshente është kërkuar pelhura e klasifikuar me UPF 50+ për të bllokuar 98% rrezeve UV ndërkohë OE nuk ka paraqitur në skedë teknike të dhëna për këtë specifikim.

Sa me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit Ekonomik **EXTRABIS Shpk NUIS L22218008Q** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, **duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.**

4. Operatori Ekonomike Grelek shpk me NUIS M12410008F

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,567.50 (shtatë milion e katërqind e dyzet e nente mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pike pesëdhjetë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481 (tete milion e nenteqind e tridhjetë e nente mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) leke.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) , nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekonomik dhe teknik të paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se Operatori ekonomik **Grelek shpk NUIS M12410008F** nuk përmbush kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit si më poshtë:

- OE nuk plotëson shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE për disa zera si më poshtë :

Per zerin 2 pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për këpucët antistatike, konstatohet se produkti i ofertuar nuk plotëson kërkesën për membranë 100% ujëdaluese. Për rrjedhojë, nuk provohet plotësisht përmbushja e të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara.

Per zerin 18 pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nuk provohet përputhshmëria e plotë me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara, pasi materiali i deklaruar është ABS dhe polikarbonat, ndërsa është kërkuar polietilen i injektuar me densitet të lartë (HDPE). Gjithashtu, nuk paraqiten të dhëna për peshën e produktit, brezin prej pëlhure për thithjen e djersës, si dhe karakteristikat konstruktive të guaskës të përcaktuara në specifikimet teknike. Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nuk provon plotësisht përmbushjen e të gjitha kërkesave teknike të artikullit.

Per zërin 20 pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur për zërin “Brezore veglash”, konstatohet se produkti i ofertuar nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara. Është kërkuar brezore tip rripi brezant, e pajisur me ndarje për vendosjen e aksesoreve dhe veglave të punës, e përshtatshme për elektrikistë. Ndërsa produkti i ofertuar është një rrip mbërthyes trupi (full body harness) për mbrojtje kundër rënies nga lartësia, i certifikuar sipas standardeve për pajisje të mbrojtjes nga rënia. Produkti i ofertuar ka funksion dhe përdorim të ndryshëm nga artikulli i kërkuar dhe nuk disponon karakteristikat kryesore teknike të brezores për vegla. Për rrjedhojë, artikulli nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara.

Sa me siper pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit Ekonomik **Grelek shpk NUIS M12410008F** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, **duke e skualifikuar kete operator ekonomik.**

5. Operatori Ekonomike MALBERTEX shpk me NUIS K 71821009 N

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,874,040 (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyzet) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 9,448,848 (nëntë milion e katërqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind e dyzetë e tetë) leke

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) , nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekonomik dhe teknik të paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se Operatori ekonomik **MALBERTEX shpk NUIS K 71821009 N** nuk përmbush kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit si me poshte:

- OE nuk plotëson piken 2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..... **pasi nuk ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkia Lezhe për përmbushjen me sukses të kontratës.**
- OE nuk plotëson shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE për disa zera si me poshte :

Per zërin 18 kokore nuk përputhet pesha 405 gr kundrejt kërkesës rreth 300 gr të kërkuar në DST.

Per zerin 16 . Doreza pune profesionale nuk ka dorëzuar te dhënat sipas kërkesës ne DST sipas standartit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë SSH EN 21420 :2020;SSH EN 388:2016+A1:2018 ose ekuivalentit të tyre.

Per Zer in 21: Artikulli Syze sigurie mungon skeda teknike sipas kërkeses ne DST.

Sa me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit te ofertës per gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit Ekonomik **MALBERTEX shpk me NUIS K 71821009 N** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, **duke e skualifikuar kete operator ekonomik.**

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatori ekonomikë i mëposhtëm është identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Operatori Ekonomike Blerina Sadiku P.Fizik me NUIS K97730102T

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,567.50 (Shtate milion e katerqind e dyzet e nente mije e peseqind e gjashtedhjetë e shtate pike pesë) leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481.00 (Tete milion e nenteqind etridhjetë e nente mije e katerqind e tetedhjetë e nje) leke

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 92, Kreu XI të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) , nenit 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit ekonomik dhe teknik të paraqitur nga ky operator ekonomik, nga ku rezultoi se **Operatori Ekonomike Blerina Sadiku P.Fizik me NUIS K97730102T** permbush te gjitha kriteret per kualifikim te përcaktuar ne dokumentat standarte të tenderit duke e shpallur ofertë të vlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të pikës 3, neni 80 dhe nenit 87 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) , si dhe pikës 5, neni 82, Kreu X të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) në përputhje me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, vendosi të bëjë klasifikimin si më poshtë:

1. Operatori Ekonomike Blerina Sadiku P.Fizik me NUIS K97730102T

Çmimi total i Ofertës pa TVSH është: 7,449,567.50 (Shtate milion e katerqind e dyzet e nente mije e peseqind e gjashtedhjetë e shtate pike pesë)leke

Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: 8,939,481.00 (Tete milion e nenteqind e tridhjetë e nente mije e katerqind e tetedhjetë e nje) lekë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në mbështetje të Nenit 81, Kreu XI të Ligjit Nr.162 , datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” vendosi të njoftojë menjëherë **Operatori Ekonomike Blerina Sadiku P.Fizik me NUIS K97730102T** pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin e deklaruar më sipër i cili do të pasqyrohet në faqen elektronike të APP- së .

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR